logo Image not found or type unknown

# Platforma për të Drejtat e Njeriut

## Constitutional Articles: E Drejta për Mjete Juridike

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

### Constitutional Paragraph: Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

| **Instrumentet ndërkombëtare** | **Nenet** |
|---|---|
| Pakti Nderkombëtar pët të Drejtat civile dhe Politike<br>Pakti Nderkombëtar pët të Drejtat civile dhe Politike | Neni 2 para 3<br><br>Çdo shtet pal? i k?tij Pakti zotohet:<br><br>(a) T? sigurojë q? çdo person, kur t’i shkelen t? drejtat dhe lirit? e njohura në këtë Pakt, t? ket? t? drejt?n e nj? mjeti juridik efektiv, edhe at?her? kur shkeljen e kryejnë personat me rastin e ushtrimit t? funksioneve t? tyre zyrtare:<br><br>(b) T? sigurojë që autoriteti kompetent gjyq?sor, administrativ ose legjislativ, ose çdo autoritet tjetër q? ?sht? kompetent n? baz? t? legjislacionit t? shtetit, do t’i p?rcaktoj? t? drejtat e k?tij personi q? paraqet mjetin juridik si dhe t? zhvilloj? mund?sit? e paraqitjes së mjetit juridik.<br><br>(c) T? sigurojë që autoritetet kompetente do të veprojnë sipas çdo mjeti juridik q? do t? njihet si i p?rligjur. |
| Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj<br>Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj | Neni 13<br><br>Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare. |
| Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut<br>Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut | Neni 8<br><br>Secili ka të drejtë që me mjete juridike efektive para gjykatave kompetente kombëtare të mbrohet nga veprimet e shkeljes së të drejtave themelore të garantuara me kushtetutë a me ligj. |

| **Instrumentet ndërkombëtare** | **Nenet** |
| --- | --- |
| Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje<br>Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje | Neni 29.1<br><br>Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t'u ofruar viktimave mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autorit të veprës penale |
| Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje<br>Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje | Neni 29.2<br><br>Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t'u ofruar viktimave, në përputhje me parimet e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare, mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autoriteteve Shtetërore që nuk kanë mundur të përmbushin detyrën e tyre për të marrë masa të nevojshme parandaluese ose mbrojtëse brenda objektit të kompetencave të tyre |
| Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje<br>Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje | Neni 30.1<br><br>Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të kenë të drejtë për të kërkuar kompensim nga autorët për çdo shkelje të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë |
| Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje<br>Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje | Neni 55.2<br><br>Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, mundësinë për organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare dhe këshilltarët mbi dhunën në familje për të ndihmuar dhe / ose bështetur viktimat, me kërkesë të tyre, gjatë hetimeve dhe procedimeve gjyqësore në lidhje me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë. |
| Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje<br>Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje | Neni 56.1<br><br>Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimave, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë, në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedimeve gjyqësore, në veçanti: |

| **Instrumentet ndërkombëtare** | **Nenet** |
|---|---|
| Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje<br>Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje | Neni 56.1 pika c<br><br>duke i informuar ata, sipas kushteve të parashikuara nga ligji i rendshëm, për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion të tyre dhe shqyrtimin e ankesës së tyre, akuzat, ecurinë e përgjithshme të hetimit ose të procedimit, dhe rolin e tyre në to, si dhe rezultatin e çështjes së tyre;<br><br>Neni 56.1 pika d |
| Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje<br>Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje | duke bërë të mundur që viktimat, në mënyrë të pajtueshme me rregullat procedurale të ligjit të brendshëm, të dëgjohen, të sigurojnë prova dhe të paraqesin pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një ndërmjetësi, si dhe marrjen e tyre në shqyrtim;<br><br>e duke u siguruar viktimave shërbime mbështetëse të duhura në mënyrë që të drejtat<br><br>dhe interesat e tyre të paraqiten siç duhet dhe të merren parasysh; |
| Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje<br>Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje | Neni 52.2<br><br>Palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që viktimat e një vepre penale të parashikuar në pajtim me këtë Konventë dhe të kryer në territorin e një Pale të ndryshëm nga ai ku ata banojnë, mund të bëjnë një ankesë para autoriteteve kompetente të Shtetit të tyre të vendbanimit. |

| **Ligjet** | **Nenet** |
|---|---|
| Ligji Nr. 05/L -021 për mbrojtje nga diskriminimi<br>Ligji Nr. 05/L -021 për mbrojtje nga diskriminimi | Neni 13<br><br>1. Çdo person ose grup i personave që ankohen se kanë qenë të diskriminuar mbi bazat e përmendura në nenin një (1) të këtij Ligji mund të paraqesin padi në gjykatën kompetente. 2. Shoqatat, organizatat apo subjektet tjera juridike mund të inicojnë apo përkrahin procedura ligjore në emër të parashtruesit, me marrjen e pëlqimit të tyre, për zhvillimin e procedurave administrative apo gjyqësore të parapara për zbatimin e obligimeve nga ky ligj. |

| **Ligjet** | **Nenet** |
| --- | --- |
| KODI NR. 06/L-074 KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS<br>KODI NR. 06/L-074 KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS | Neni 97<br><br>Rehabilitimi gjyqësor Gjykata, me kërkesën e personit të dënuar, mund të vendosë që dënimi t'i shlyhet nga evidenca e personit të dënuar dhe ai person konsiderohet i padënuar nëse ka kaluar gjysma e afatit përkatës të paraparë me paragrafin 2. të nenit 96 të këtij Kodi dhe nëse personi i dënuar gjatë kësaj kohe nuk ka kryer vepër të re penale. Me rastin e vendosjes për shlyerjen e dënimit të parashkruar ose përfunduar me falje ose me ndryshim të Kodit Penal, gjykata merr parasysh sjelljen e personit të dënuar pas mbajtjes së dënimit, natyrën e veprës penale dhe rrethanat e tjera të cilat mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin e përshtatshmërisë së shlyerjes së dënimit |
| Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE<br>Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE | Neni 124.1<br><br>Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtari i një organi kolegjial, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjial, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë. |
| Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE<br>Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE | Neni 124.4<br><br>Mjet juridik administrativ përjashtimor është rihapja e procedurës administrative |
| Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE<br>Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE | Neni 125.1<br><br>Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative |
| Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE<br>Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE | Neni 130.4<br><br>Pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit për ndalimin e efektit pezullues në gjykatën kompetente për konfliktet administrative, brenda pesë (5) ditëve nga njoftimi i tij |

| **Ligjet** | **Nenet** |
|---|---|
| Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE<br>Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE | Neni 156.1<br><br>Pa cenuar të drejtën e palës për t'u ankuar ndaj aktit administrativ që ekzekutohet, pala mund të parashtrojë një ankesë kundër urdhrit të ekzekutimit. Ankesa mund të parashtrohet vetëm lidhur me pretendimet ndaj vendit, kohës dhe mjeteve të ekzekutimit dhe parashtrimi i saj nuk pezullon vazhdimin e ekzekutimit. |
| Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE<br>Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE | Neni 156.3<br><br>Pala, gjithashtu mund të parashtrojë një kundërshtim administrativ kundër veprimeve të ekzekutimit, nëse ato tejkalojnë pjesën e detyrueshme të aktit që ekzekutohet, apo kur pretendohet të jenë të paligjshme. |
| LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE<br>LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE | Neni 176.1<br><br>Kundër aktgjykimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë palët mund të bëjnë ankim brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh (15) nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, po që se me këtë ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër. Në kontestet nga raportet në të cilat është dhënë aktgjykimi në bazë të kambialit apo çekut, afati për ankim është shtatë (7) ditor. |
| LIGJI NR.03/L-121 PËR GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS<br>LIGJI NR.03/L-121 PËR GJYKATËN KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS | Neni 47<br><br>Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. 2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. |
| LIGJI NR.03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT<br>LIGJI NR.03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT | Neni 6 para 11<br><br>11. Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë, çdo person juridik ose fizik dhe publiku, në rast të pësimit të dëmit material ose është para një rreziku të pësoj dëm material që ka të bëjë me një aktivitet të veçantë ose burim të ndotjes që bën shkeljen e dispozitave të këtij ligji, ligjeve të veçanta ose akteve nënligjore të nxjerra në bazë të ligjit, ka të drejtë të ngre padi ose të kërkojë nga gjykata kompetente ose autoriteti publik të mbroj të drejtat e veta |

| Ligjet | Nenet |
|---|---|
| LMDHP 06/L-082<br>LIGJI NR. 06/L-082 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE | Neni 52<br><br>1. Pa cenuar mjetet e tjera administrative ose gjyqësore të mbrojtjes, çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të paraqesë ankesë tek Agjencia, nëse subjekti i të dhënave pretendon që përpunimi i të dhënave personale, në lidhje me të, e shkelë këtë ligj. 2. Agjencia njofton ankuesin mbi progresin dhe rezultatin e ankesës, duke përfshirë mundësinë e një mjeti ankimi gjyqësor, në pajtim me nenin 54 të këtij ligji. |
| LIGJI NR. 06/L-081 PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE<br>LIGJI NR. 06/L-081 PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE | Neni 20.1<br><br>1. Në rast se institucioni publik ka refuzuar në tërësi apo pjesërisht kërkesën për qasje në dokumente publike apo në rast të heshtjes apo mos përgjigjes së institucionit publik, kërkuesi mund t'i drejtohet me ankesë Agjencisë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej pranimit të vendimit për refuzim ose vendimit për aprovim të pjesshëm të kërkesës për qasje |
| LIGJI NR. 05/L-053 PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRËN E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR<br>LIGJI NR. 05/L-053 PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRËN E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR | Neni 49.2<br><br>3. Në pajtim me nenin 113(7) të Kushtetutës, individët, përfshirë të akuzuarit dhe viktimat, janë të autorizuar që t'i drejtohen Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese lidhur me shkeljet e të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, që pretendohen se janë bërë nga Dhomat e Specializuara apo nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, por vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE<br>KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 14.10<br><br>I pandehuri ka të drejtë të ushtrojë ankesë kundër vendimit me të cilin i mohohet përkthimi |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE<br>KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 40.4<br><br>Kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit apo të Gjykatës Supreme pala mund ta bëjë në ankesë ose në përgjigje në ankesë |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE<br>KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 41.3<br><br>Kundër aktvendimit me të cilin pranohet kërkesa për përjashtim nuk lejohet ankesë. Aktvendimi me të cilin kërkesa për përjashtim refuzohet mund të kundërshtohet me ankesë të posaçme |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE<br>KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 60.3<br><br>Kundër aktvendimit për shkarkimin e mbrojtësit lejohet ankesë e veçantë. |

| **Ligjet** | **Nenet** |
| --- | --- |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 78.2<br><br>Personi ndaj të cilit është ndërmarrë ndonjë masë nga nenet 70-78 të këtij Kodi ka të drejtë të parashtrojë ankesë te prokurori kompetent i shtetit brenda tre (3) ditëve nga ndërmarrja e këtyre masave |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 84.5<br><br>Në qoftë se prokurori i shtetit e ka hedh poshtë kallëzimin penal, i dëmtuari ose viktima mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit për hedhjen e kallëzimit penal brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i njoftimit sipas paragrafit 4 të këtij neni. Ankesa paraqitet në Prokurorinë e Apelit përmes prokurorisë themelore. Ankesa duhet të përmbajë faktet dhe arsyet e ankesës |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 84.8<br><br>Pas kalimit të afatit prej gjashtë (6) muajsh nga paraqitja e kallëzimit penal apo aktvendimit nga paragrafi 6 i këtij neni, i dëmtuari ose viktima mund të parashtrojë ankesë drejtpërdrejtë në Prokurorinë e Apelit për dështimin e prokurorit që të ndërmerr veprime. Procedura e paraparë paragrafin 6 dhe 7 të këtij neni zbatohet përshtatshmërisht |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 95.4<br><br>Pas ngritjes së aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues vlerëson kundërshtimet e të pandehurit lidhur me pranueshmërinë e provave të mbledhura. Kundër vendimit mbi kundërshtimin nga ky paragraf mund të paraqitet ankesë |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 95.4<br><br>Pas ngritjes së aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues vlerëson kundërshtimet e të pandehurit lidhur me pranueshmërinë e provave të mbledhura. Kundër vendimit mbi kundërshtimin nga ky paragraf mund të paraqitet ankesë |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 96.5<br><br>Kur personi konsideron se i është nënshtruar një mase të kundërligjshme sipas këtij Kapitulli apo një urdhri të kundërligjshëm për një masë nga ky kapitull, ai mund të paraqesë ankesë te kryetari i gjykatës themelore, i cili, nëse pretendohet ndonjë shkelje e ligjit, emëron Panelin për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit për të vendosur |

| Ligjet | Nenet |
|---|---|
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 110.17<br><br>Ne?se personi apo organi i cili ka ne?n mbike?qyrje provën apo pasurinë e specifikuar qe? i nënshtrohet urdhrit te? gjykatës refuzon t'ia dore?zoje? provën apo pasurinë e specifikuar zyrtarit te? autorizuar te? policise? qe? e?shte? përgjegjës pe?r ekzekutimin e urdhrit, personi apo organi i tille? i nënshtrohet ndjekjes për pengim të të provuarit apo procedurës zyrtare nga neni 386 i Kodit Penal dhe mund te? gjobitet nga gjyqtari i procedure?s paraprake deri ne? pese?dhjete? pe?rqind (50%) te? vlere?s se? provës apo pasurisë së specifikuar. Personi apo organi ndaj te? cilit shqiptohet gjoba e tille? mund te? paraqese? ankese? kunde?r gjobe?s brenda shtatë (7) ditësh nga shqiptimi i saj ose mund te? shmange? gjobe?n duke iu bindur urdhrit ndalues të përkohshëm menjëherë por jo më vonë se shtatë (7) ditë nga dita kur vendimi për të shqiptuar gjobën merr formën e prerë. |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 147.3<br><br>Kolegjit shqyrtues mund t'i paraqitet ankesë kundër mospranimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për marrjen e dëshmisë së tillë |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 156.8<br><br>Kur prokurori i shtetit pushon hetimin, i dëmtuari ose viktima mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit për pushimin e hetimit në Prokurorinë e Apelit, përmes prokurorisë themelore. Dispozitat e nenit 84 të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 162.5<br><br>Sa më shpejtë që është e mundur pas arrestimit dhe jo më vonë se gjashtë (6) orë nga koha e arrestimit, prokurori i shtetit i lëshon personit të arrestuar vendimin me shkrim mbi ndalimin, që përfshin emrin dhe mbiemrin e personit të arrestuar, nëse dihen, apo nëse nuk dihen, çfarëdo informacioni për të identifikuar në mënyrë adekuate personin e arrestuar, vendin, ditën dhe kohën e saktë të arrestimit, veprën penale për të cilën dyshohet dhe bazën juridike për arrestim. Kundër vendimit për ndalim të lëshuar nga prokurori i shtetit, i arrestuari apo mbrojtësi i tij mund të ushtrojë ankesë brenda gjashtë (6) orësh nga momenti i pranimit të vendimit. Lidhur me këtë ankesë vendos gjyqtari i procedurës paraprake brenda dymbëdhjetë (12) orëve nga momenti i pranimit të ankesës |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 162.13<br><br>Ndaj aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për caktim të paraburgimit mund të paraqitet ankesë në përputhje me dispozitat e nenit 186, paragrafi 3 të këtij Kodi |

| **Ligjet** | **Nenet** |
| --- | --- |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 186.3<br><br>Secila palë mund të paraqesë ankesë brenda dyzet e tetë (48) orëve nga koha e dorëzimit të aktvendimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit. Nëse ankohet vetëm njëra palë, gjykata ia dërgon ankesën palës tjetër e cila argumentet e veta mund t'ia paraqesë gjykatës brenda njëzet e katër (24) orëve, nga dorëzimi i ankesës. Për ankesë vendoset brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga paraqitja e përgjigjes, apo skadimi i afatit për parashtrimin e përgjigjes në Gjykatën e Apelit |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 188.3<br><br>Ndaj çdo aktvendimi mbi vazhdimin e paraburgimit mund të ushtrohet ankesë. Neni 186, paragrafët 3 dhe 4, zbatohen përshtatshmërisht |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 190.1<br><br>Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në shpallje të aktgjykimit apo seancën për caktimin e dënimit, nëse ka të tillë, paraburgimi mund të caktohet, vazhdohet ose të hiqet vetëm me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose trupit gjykues në seancë. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues së pari dëgjon mendimin e prokurorit të shtetit dhe mendimin e të pandehurit ose mbrojtësit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese. Neni 186, paragrafët 3 dhe 4 të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 190.2<br><br>Pasi të kalojnë dy (2) muaj nga aktvendimi i fundit për paraburgim, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues edhe pa propozimin e palëve shqyrton nëse ende ekzistojnë arsyet për paraburgim dhe merr aktvendim për vazhdimin ose heqjen e paraburgimit. Kundër aktvendimit palët kanë të drejtë ankese. Neni 186, paragrafët 3 dhe 4 të këtij Kodi zbatohen përshtatshmërisht |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 198.4<br><br>Kundër vendimit për shqiptimin e masës disiplinore nga paragrafi 1 i këtij neni mund të paraqitet ankesë te gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në afat prej njëzet e katër (24) orëve nga pranimi i vendimit. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 210.3<br><br>Nëse prokurori i shtetit refuzon shikimin e shkresave, i dëmtuari mund t'i paraqesë ankesë gjyqtarit të procedurës paraprake. Vendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake është përfundimtar |

| **Ligjet** | **Nenet** |
|---|---|
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 210.4<br><br>Nëse gjyqtari i procedurës paraprake refuzon shikimin e shkresave me të cilat disponon gjykata, atëherë mund të paraqitet ankesë në kolegjin shqyrtues |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 230.12<br><br>Marrëveshja po ashtu mund të përfshijë dispozitën ku palët pajtohen për kufijtë e dënimit që do të propozohet nga ana e prokurorit të shtetit nëse i pandehuri bashkëpunon thelbësisht, ndërsa nëse gjykata shqipton dënim jashtë këtyre kufijve në dëm të ndonjërës prej palëve, ajo palë ka të drejtë ankese kundër vendimit mbi dënimin |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 243.6<br><br>Secila palë mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit nga paragrafit 3 të këtij neni. Ankesa duhet të bëhet brenda dhjetë (10) ditëve nga pranimi i aktvendimit me shkrim |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 297.3<br><br>Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund ta shkarkojë mbrojtësin nga shqyrtimi gjyqësor kur pas dënimit ai vazhdon të prish rendin dhe në këtë rast kërkon nga pala që të angazhojë një mbrojtës tjetër. Kur i akuzuari nuk mund të angazhojë mbrojtës tjetër menjëherë, apo kur gjykata atë nuk mund ta caktojë më vonë pa e dëmtuar mbrojtjen, shqyrtimi gjyqësor ndërpritet ose shtyhet. Kundër aktvendimit për shkarkimin e mbrojtësit, i pandehuri mund të paraqesë ankesë, në afat prej tre (3) ditëve. Lidhur me ankesën Gjykata e Apelit vendosë në afat prej tre (3) ditëve |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 298.1<br><br>Kundër aktvendimit për dënimin lejohet ankesë dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund ta revokojë aktvendimin e tillë |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 303.6<br><br>Në rast të gjykimit të mbajtur sipas paragrafit 2 të këtij neni, gjykata bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar të pandehurin lidhur me aktgjykimin. Mirëpo, nëse gjykata nuk është në gjendje ta njoftojë të pandehurin për shkak të mungesës së tij, mbrojtësi ka të drejtë të bëj ankesë ndaj aktgjykimit në emër të të pandehurit sipas nenit 383 të këtij Kodi. Kur vepron ashtu, mbrojtësi tregon se ai ka marrë parasysh interesin më të mirë të të akuzuarit. Dispozitat e nenit 380 të këtij Kodi në lidhje me afatin zbatohen përshtatshmërisht. |

| **Ligjet** | **Nenet** |
| --- | --- |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE<br>KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 374.1<br><br>Përveç rasteve kur parashihet ndryshe me këtë Kod, pala mund të paraqesë mjetin juridik në gjykatën e shkallës drejtpërdrejtë më të lartë përmes:<br><br>**1.1 “** ankesës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit;<br><br>**1**.2 ankesës kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme të Kosovës sipas paragrafit 1 të nenit 407 të këtij Kodi;<br><br>**1.3** “ankesës kundër aktvendimit apo urdhrit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit;<br><br>**1.4** “ankesës kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme, kur Gjykata e Apelit e ndryshon aktvendimin e gjykatës themelore lidhur me paraburgimin apo kur paraburgimi caktohet për herë të parë në Gjykatën e Apelit;<br><br>**1.5** ”kundërshtimit kundër vendimit gjyqësor të gjykatës themelore siç përcaktohet me këtë Kod;<br><br>**1.6**.mjetit të jashtëzakonshëm juridik të paraqitur kundër vendimit të Gjykatës Themelore apo të Gjykatës së Apelit në Gjykatën kompetente. |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE<br>KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 380.1<br><br>Kundër aktgjykimit të marrë nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues i gjykatës themelore, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE<br>KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 381.3<br><br>I dëmtuari ose viktima mund të ushtrojë ankesë ndaj aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për trafikimin me qenie njerëzore, dhunën në familje, veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për kërkesën pasurore juridike kur i akuzuari shpallet fajtor si dhe për shpenzimet e procedurës penale që ndërlidhen me të. |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE<br>KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 381.4<br><br>Ankesë mund të paraqesë edhe personi, pasuria e të cilit është konfiskuar |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE<br>KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 387.1<br><br>Ndaj aktgjykimit mund të paraqitet ankesë lidhur me vendimin mbi shqiptimin e sanksionit penal kur gjykata, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, përkundër mos tejkalimit të kompetencave ligjore nuk e ka caktuar drejt sanksionin penal. |

| Ligjet | Nenet |
|---|---|
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 387.2<br><br>Ndaj aktgjykimit gjithashtu mund të ushtrohet ankesë kur gjykata ka zbatuar ose nuk ka zbatuar dispozitat për zbutjen ose lirimin nga dënimi apo të vërejtjes gjyqësore. |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 388.1<br><br>Ankesa kundër aktgjykimit paraqitet në gjykatën e cila ka nxjerr aktgjykimin. |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 408.1<br><br>Kundër aktvendimeve ose urdhrave të gjyqtarit të procedurës paraprake dhe kundër aktvendimeve ose urdhrave të tjera të gjykatës themelore, palët dhe personat të drejtat e të cilëve janë shkelur, në pajtim me nenin 411 të këtij Kodi mund të paraqesin ankesë, me përjashtim kur me dispozitat e këtij Kodi shprehimisht nuk lejohet ankesë e tillë |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 411.1<br><br>Ankesa kundër aktvendimit ose urdhrit mund të paraqitet nga ana e prokurorit të shtetit, mbrojtësit, të dëmtuarit ose viktimës, mbrojtësit të viktimave ose përfaqësuesit të viktimës dhe nga secili person i cili është i përfshirë në aktvendim ose urdhër. Personi i autorizuar paraqet ankesë në pajtim me këtë Kapitull. |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 446.1<br><br>Nëse i pandehuri për shkaqe të arsyeshme nuk paraqet ankesë kundër aktgjykimit ose aktvendimit për konfiskimin brenda afatit, gjykata i lejon kthim në gjendje të mëparshme për paraqitjen e ankesës nëse brenda tetë (8) ditësh nga pushimi i shkaqeve për mosrespektimin e afatit i pandehuri paraqet kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme dhe paraqet ankesën së bashku me kërkesë. |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 500.1<br><br>Kundër aktgjykimit për vërejtjen gjyqësore mund të paraqitet ankesë sipas arsyeve të parapara në nenin 383, paragrafi 1 nën-paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij Kodi, si dhe për shkak të mosekzistimit të rrethanave që e arsyetojnë shqiptimin e vërejtjes gjyqësore. |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 500.3<br><br>Kundër aktvendimit mbi aftësinë e të pandehurit për t'iu nënshtruar gjykimit mund të ushtrohet ankesë |

| Ligjet | Nenet |
| --- | --- |
| KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE | Neni 514.4<br><br>Të gjithë personat të cilët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër aktgjykimit, përveç të dëmtuarit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë kundër aktvendimit të gjykatës brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së aktvendimit. |
| LIGJI NR. 08/L-209 PËR INVESTIME TË QËNDRUESHME LIGJI NR. 08/L-209 PËR INVESTIME TË QËNDRUESHME | Neni 45.1<br><br>Investitori mund t’i parashtrojë Panelit Ankimor ankesë ndaj institucioneve publike për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së investimit, me përjashtim të ankesës ndaj vendimit të Këshillit. |
| LIGJI NR. 08/L-209 PËR INVESTIME TË QËNDRUESHME LIGJI NR. 08/L-209 PËR INVESTIME TË QËNDRUESHME | Neni 45.4<br><br>Investitori mund të përdorë mjet tjetër juridik pa marrë parasysh a ka parashtruar ankesën nga paragrafi 1 i këtij neni |
| Ligji nr. 08/l-197 për zyrtarët publik Ligji nr. 08/l-197 për zyrtarët publik | Neni 27.3<br><br>Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil |
| Ligji nr. 08/l-197 për zyrtarët publik Ligji nr. 08/l-197 për zyrtarët publik | Neni 39.12<br><br>Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMShCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative’’ |
| Ligji nr. 08/l-197 për zyrtarët publik Ligji nr. 08/l-197 për zyrtarët publik | Neni 44.10<br><br>Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMShCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative’’ |
| Ligji nr. 08/l-197 për zyrtarët publik Ligji nr. 08/l-197 për zyrtarët publik | Neni 47.10<br><br>Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMShCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative’’ |

| Ligjet | Nenet |
|---|---|
| Ligji nr. 08/l-197 për zyrtarët publik<br>Ligji nr. 08/l-197 për zyrtarët publik | Neni 52.17<br><br>Nëpunësja/i civil e cila nuk është e kënaqur me vlerësimin si në paragrafin 13. nën-paragrafit 13.4. dhe 13.5. të këtij neni, ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMShCK, sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative |
| Ligji nr. 08/l-197 për zyrtarët publik<br>Ligji nr. 08/l-197 për zyrtarët publik | Neni 88.1<br><br>Nëpunësja/i i shërbimit publik mund të ankohet kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Të drejtën e ankesës e kanë dhe kandidatët në procedurë rekrutuese në shërbimin publik |
| LIGJI NR. 08/L-205 PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA<br>LIGJI NR. 08/L-205 PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA | Neni 129.7<br><br>Kundër vendimit të gjykatës që ka vendosur masat e përkohshme ose paraprake, mund të ushtrohet ankesë e veçantë, për ndryshimin ose heqjen e masave. Ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit. |
| LIGJI NR. 08/L-205 PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA<br>LIGJI NR. 08/L-205 PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA | Neni 131.3<br><br>Bartësit e të drejtave mund të aplikojnë për një urdhër gjyqësor kundër ndërmjetësve, shërbimet e të cilëve përdoren nga një palë e tretë për të shkelur një të drejtë autori ose një të drejtë të përafërt |
| LIGJI NR. 08/L-205 PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA<br>LIGJI NR. 08/L-205 PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA | Neni 132.1<br><br>Gjykata, me kërkesën e të dëmtuarit, urdhëron shkelësin, i cili e ka ditur ose ka pas arsye të bazuara për ta ditur, ka kryer një shkelje, t'i paguajë bartësit të së drejtës dëmshpërblim në përputhje me dëmin që ka pësuar si pasojë e shkeljes. |
| LIGJI NR. 08/L-205 PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA<br>LIGJI NR. 08/L-205 PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA | Neni 132.2<br><br>Padia për shkeljen e të drejtave mund të paraqitet në gjykatë në afat prej tre (3) vjetësh nga dita kur paditësi ka marrë dijeni për shkeljen dhe identitetin e shkelësit |

| **Ligjet** | **Nenet** |
| --- | --- |
| LIGJI NR. 08/L-205 PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA<br>LIGJI NR. 08/L-205 PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA | Neni 133<br><br>Gjykata mund të urdhërojë, me kërkesën e paditësit dhe me shpenzimet e shkelësit masat e duhura për shpërndarjen e informacionit në lidhje me vendimin, duke përfshirë publikimin e vendimit të tillë, tërësisht ose pjesërisht, në mjetet e informimit masiv, në rrethana të njëjta, gjykata mund të urdhërojë masa shtesë njoftimi, në përputhje me kërkesat e veçanta të çështjes, duke përfshirë një publicitet të lartë”. |
| LIGJI NR. 08/L-205 PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA<br>LIGJI NR. 08/L-205 PËR TË DREJTËN E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA | Neni 137.3<br><br>Të gjitha ankesat lidhur me shkeljen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, gjatë transmetimit dhe ritransmetimit të programeve do të procedohen nga KPM |
| LIGJI NR. 08/L-176 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË PËRMBAJNË PROCEDURA TË VEÇANTA<br>LIGJI NR. 08/L-176 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË PËRMBAJNË PROCEDURA TË VEÇANTA | Neni 32B.1<br><br>Pala e interesuar ka të drejtë të parashtrojnë ankesë kundër vendimit të institucioneve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative |
| LIGJI NR. 08/L-176 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË PËRMBAJNË PROCEDURA TË VEÇANTA<br>LIGJI NR. 08/L-176 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË PËRMBAJNË PROCEDURA TË VEÇANTA | Neni 95A paragrafi 1 2 3<br><br>**Neni 95A paragrafi 1** “Kundër secilit vendim përfundimtar të nxjerr sipas Ligjit bazik lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative”<br><br>**Neni 95A paragrafi 2** “ Kundër vendimeve të lëshuara në procedurë të inspektimit sipas këtij Ligji lejohet ankesa në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative”<br><br>**Neni 95A paragrafi 3 “**Organ epror që shqyrton ankesat sipas këtij neni është: 3.1. Komisioni i ankesave i themeluar me vendim të Ministrit në Ministrinë përgjegjëse për shëndetësi për nivelet e kujdesit shëndetësor për të cilat është përgjegjëse Ministria. 3.2. Komisioni i ankesave i themeluar nga Kryetari i Komunës për nivelet e kujdesit shëndetësor për të cilat është përgjegjëse Komuna”. |

| **decisionTitle*** | **decisionDescription*** |
| --- | --- |

**WILLE kundër LIECHTENSTEIN**

28396/95 | Gjykata (Dhoma e Madhe) 28/10/1999

WILLE kundër LIECHTENSTEIN

Komisioni gjeti se Qeveria nuk kishte arritur të tregonte se kundër shkeljes së nenit 10 të Konventës të pretenduar nga kërkuesi, ka ekzistuar një mjet i efektshëm në praktikë bazuar në të drejtën e Lihtenshtajnit. Në veçanti, lidhur me një ankesë në Gjykatën Kushtetuese, Qeveria nuk kishte paraqitur ndonjë shembull që tregonte aplikimin e saj në një rast të ngjashëm dhe aktual.

https://hudoc.echr.coe.int/eng#_Toc393886343

HUSAYN (ABU ZUBAYDAH) v. POLAND

Kërkuesi u ankua se autoritetet polake, duke shkelur nenin 13 të marrë veçmas dhe në lidhje me nenet 3, 5 dhe 8 të Konventës, kishin mohuar të drejtën e tij për një mjet efektiv për shkak të dështimit për të kryer një hetim efektiv lidhur me pretendimet e tij për shkelje të Konventës

**Boyle and Rice v. the United Kingdom, 27 April 1988**

Boyle and Rice v. the United Kingdom

E drejta për një mjet efektiv lind nëse aplikanti ka një ankesë "të diskutueshme" se ka pasur shkelje të së drejtës së Konventës. Edhe nëse Gjykata konkludon se
e drejta thelbësore nuk është shkelur, kjo nuk parandalon një ankesë sipas nenit 13 nga të qenit "i diskutueshëm". Gjykata ka thënë që edhe përkundër kushteve të neni 13, të lexuara fjalë për fjalë, se është e nevojshme të ekzistoj një shkelje e një dispozite tjetër "thelbësore"  që dispozita të jetë e zbatueshme, kjo në fakt nuk është një parakusht për sa kohë që
shkelja e pretenduar është "e diskutueshme".